

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Kjo kontrate per shitblerje kuotash lidhet ne Tiranë, sot më 30.11.2017, mes znj. Elona Lilo referuar si "Shitesi" dhe z. Harilla Çipi, referuar si "Bleresi". Shitesi dhe Bleresi referohen se bashku edhe si "Palet" dhe vecmas si "Pala".

DUKE QENE SE shoqëria "SPEED SOLUTION" sh.p.k., eshte themeluar në Shqipëri ne vitin 2013, dhe ka nje kapital prej 100.000 leke te përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlere prej 100.000 Lekë, te zoteruar 100% nga znj Elona Lilo;

DUKE QENE SE Shitesi deshiron te shese kuotën që ka në pronësi që përbën 100% te kapitalit te shoqërisë "SPEED SOLUTION" sh.p.k. dhe Bleresi ne ekzekutim te kesaj Kontrate shpreh vullnetin te bleje 100% te kapitalit te shoqerise "SPEED SOLUTION" sh.p.k., sipas percaktimeve dhe kushteve te vendosura ne kete Kontratë;

NE PERPUTHJE ME SA ME SIPER u parashtruan, premtimet e ndersjella, marreveshjet, perfaqesimet dhe garancite e permbajtura ne kete dokument, si edhe sipas percaktimeve dhe kushteve te vendosura ne kete Kontratë, Shitesi dhe Bleresi bien dakord si vijon:

Cdo marreveshje paraprake e arritur mes paleve sa me siper pranohet dhe miratohet si pjese e dispozitave vazhduese.

Neni 1

Palët e kontratës

1. Palët e kësaj kontrate janë:
 - a. Z. **Harilla Çipi**, shtetas shqiptar, i biri i Akile dhe Eftimia, lindur dhe banues në Durrës, i datëlindjes 19.04.1977, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. 027643599 dhe Nr. Personal H70419178K, referuar ne kete kontrate si Bleresi; dhe
 - b. Znj. **Elona Lilo**, shtetase shqiptare, e bija e Dilaver dhe Shpresa, lindur më 03.11.1987 në Sarandë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plote juridike per te vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 029158232 dhe Nr. Personal I76103067F, referuar ne kete kontrate si Shitesi;
2. Palët dhe/ose përfaqësuesit e palëve sa më sipër gëzojnë të gjitha tagrat për të përfaqësuar personin e tyre fizik në pranimin e termave të kësaj kontrate dhe nënshkrimin e saj.
3. Palët i kanë paraqitur njëra tjetrës gjithë autorizimet që legjitimojnë praninë e tyre në këtë kontratë dhe i kanë pranuar ato si të vërteta dhe të rregullta.

Neni 2

Objekti i kontratës



Objekti i kesaj kontrate eshte shitblerja e 100% te kapitalit (e përbërë nga 1 (një) kuotë) te shoqerise "SPEED SOLUTION" sh.p.k., te zoteruar nga ortaku Elona Lilo. Kuota do t'i shitet z. Harilla Çipi.

Neni 3

Baza ligjore

Kalimi i kuotave me kete kontrate bazohet ne nenin 73 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" të ndryshuar.

Neni 4

Garancitë e ndërsjella

Shitesi garanton Bleresin se eshte pronar me te drejta te plota mbi objektin e kontrates, e zoteron te plote dhe te lire e pa asnje barre renduese dhe se te gjitha garancite e treguara dhe te pranuar nga Bleresi, vazhdojne te mbeten te vlefshme deri ne ekzekutimin e plote te kesaj kontrate si dhe ne çdo moment pas permbushjes se kontrates.

Neni 5

Vlera e kontratës

1. Shitesi ka rene dakord t'ia shese Bleresit objektin e kesaj kontrate, me nje cmim prej 100.000 (njëqind mijë) Leke dhe Bleresi ka rene dakord t'ia bleje Shitesit perkatesisht objektin e kesaj kontrate, me kete cmim. Cmimi i shitjes eshte i barabarte me vleren nominale te kuotes, sipas statutit te shoqerise.
2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi pranon se pagesa sa me siper eshte kryer nga Bleresi dhe se Shitesi nuk ka me asnje pretendim lidhur me kryerjen e pageses sipas kesaj kontrate.

Neni 6

Transferimi i kuotës

1. Transferimi i kuotës do te behet duke ekzekutuar kontraten nepermjet regjistrimit te transferimit ne regjistrin tregtar. Regjistrimet kryhen ne perputhje me afatet ligjore.
2. Palet konfirmojne se pas ekzekutimit te kesaj kontrate dhe perfundimit te procedurave per kalimin e kuotës vetem per efekt te kesaj kontrate, ortaku Elona Lilo nuk do te vazhdoje te zoteroje me kuota te shoqerise "SPEED SOLUTION" sh.p.k. duke u larguar nga shoqeria, ndersa ortaku Harilla Çipi do te zoteroje 100% të kapitalit të shoqërisë "SPEED SOLUTION" sh.p.k. të përbërë nga 1 (një) te kuotë duke u bere ortak i vetem.

Neni 7

Detyrime të shitësit dhe blerësit

Shitesi dhe Bleresi kane detyrimin qe te permbushin me rigorozitet kushtet e percaktuara ne kete kontrate.



2

Shitesi dhe Bleresi jane pergjegjes ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotës, nga casti i kalimit te kuotës deri ne regjistrimin e kalimit te saj ne regjistrin tregtar.

Palët pergjigjen perkatesisht per detyrimet fiskale qe mund te aplikohen per shkak te kalimit te kuotës, mbi secilin prej tyre.

Neni 3


Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët angazhohen qe te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarreveshjet qe lindin gjate permbushjes se kesaj kontrate. Ne rast te mos zgjidhjes se mosmarreveshjeve me mirekuptim, palet kane te drejte ti drejtohen Gjykates se Tiranes.

Kjo kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, me vlefshmeri te njejte. Palet e kesaj kontrate mbajne te pakten nga nje kopje origjinale te kontrates.

SHITËSI

Elona LILO

Elona Lilo


BLERËSI

Harilla ÇIPI

Harilla Çipi
